



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 523 Prot.

Patos më 03.03.2025.

PROCESVERBAL

MBI MIRATIMIN E RENDIT TË DITËS SË MBLEDHJES SË DATËS 03.02.2025

I mbajtur sot më datë 26.02.2025 në orën 14:00 në sallën e mbledhjeve të Këshillit ku zhvillohet mbledhja e Këshillit të Bashkisë:

Prezent në fillimin e mbledhjes këta këshilltare:

1. Elmira Rama
2. Novrus Toska
3. Vjollca Kasaj
4. Eduart Faslliaj
5. Gani Ahmetaj
6. Artan Velçani
7. Albiona Lamaj
8. Klarida Semanjaku
9. Ertila Myrtaj
10. Lori Musaj
11. Erald Çepele
12. Klaudio Alisininaj
13. Smerald Hazizaj
14. Renaldo Shpata
15. Armand Ahmetaj

Takimi hapet nga kryetari i Këshillit z. Armand Ahmetaj.

Armand Ahmetaj – Përshëndetje të gjithëve!

Të nderuar anëtar koleg këshilltarë !

Të nderuar qytetar!

Kjo është mbledhja e radhës e këshillit bashkiak. Mbledhja është e bazuar në ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 53 pika 4 dhe 56 pika 2.

Pjesëmarrja në mbledhjen e këshillit është 15 këshilltarë.

Kalojmë në rendin e ditës.

- 1- Miratimi i rendit të ditës.
- 2- Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Këshillit datë 03.02.2025.
- 3- Informacion mbi vendimet e miratuara në mbledhjen e datës 03.02.2025.
- 4- Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin Janar 2025”.
- 5- Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin Janar 2025”.
- 6- Projekt-vendim “Për miratimin e bonusit të qirasë për qytetarin z. Qerem Zyberi”.
- 7- Projekt-vendim “Për miratimin e bonusit të qirasë për qytetarin z. Bardhul Aliaj”.
- 8- Projekt-vendim “Raporti për vlerësimin dhe parashikimin afatmesëm të të ardhurave të veta (Bashkia Patos 2026-2028)”.
- 9- Shqyrtimi i kërkesës nr. 4202 prot., datë 20.11.2024 për dhënie ndihmë financiare.
- 10- Informacion mbi raportin e monitorimit të zbatimit të buxhetit për 4- mujorin e tretë dhe prej fillimit të vitit 2024.
- 11- Informacion mbi inventarët jashtë përdorimit nga Drejtoria e Financës.

Para se të kalojmë në votimin e rendit të ditës kush ka kërkesë për të hequr apo për tu shtuar mbi rendin e ditës?

Nëse s'ka kalojmë në votim.

Armand Ahmetaj- Kush është dakord?

Miratohet me 15 vota pro abstenim ska, kundër ska.

SEKRETARE

Refaela Xeba



KRYETAR

Armand Ahmetaj

Bendito Shyoto
Eduart Fosliq
Hatai Velcan





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 523 / Prot.
18

Patos më 03.03.2025

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 26.02.2025 ora 14:00 , në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së dytë të rendit të ditës.

Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Këshillit datë 03.02.2025.

Armand Ahmetaj – Jeni njohur me materialin, kemi ndonje verejtje ndonjë paqartësi? Nëse s'keni me pelqim unanimitet neni 77 i rregullores miratohet procesverbali.

SEKRETARE
Refaela Xeba

KRYETAR
Armand Ahmetaj

Remelda Shyreta
Edvort Fosllioq
Artan Jelcau



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 523 Prot.
/9

Patos më, 03 03.2025

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 26.02.2025 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së tretë të rendit të ditës.

Mbi informacionin për vendimet e miratuara në mbledhjen e datës 03.02.2025

Armand Ahmetaj– Fjala për Refaelën

Refaela Xeba -Përshëndetje të gjithëve!

Në mbledhjen e datës 03.02.2025 janë marrë gjithsej 5 vendime. Nga nr. 1 deri në nr 5.

Vendimet janë zbardhur në afat dhe i janë përcjell drejtorive përkatëse për ekzekutim. Nga keto vendime vetëm vendimi nr. 03 datë 03.02.2025 shkoi në Prefekturë dhe ka ardhur përgjigja në përputhje me ligjin

Faleminderit!

SEKRETARE

Refaela Xeba

KRYETAR

Armand Ahmetaj

Bendita Shybo
Eduart Fajkaj
Artan Velkoni



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 484 / Prot.
13

Patos më 03 03.2025.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 26.02.2025 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së katërt të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin Janar 2025”.

Armand Ahmetaj- Ju informoj se komisioni ekonomisë është mbledhur sipas njoftimit të rendit të ditës dhe është miratuar me vota unanime.

Elda Goxhaj Drejtore e Mbrojtjes Sociale dhe Politikave të Arsimit, Sektori i Shërbimit Social- Drejtorja e Mbrojtjes Sociale dhe Politikave të Arsimit, Sektori i Shërbimit Social propozon të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondet e buxhetit vendor për muajin Janar 2025 gjithsej 12 familje me një fond prej 54,987 (pesëdhjetë e katërmijë e nëntëqind e tetëdhjetë e shtatë) lekë. Familjet përfituese sipas listës dhe relacionit bashkëngjitur. Janë mbuluar të gjithë sepse kishim fond mjaftueshëm.

Armand Ahmetaj- Keni ndonjë pyetje?

Armand Ahmetaj – Kush është dakord? Nëse s’kemi pyetje të tjera unë propozoj ta kalojmë në votim pikën e katërt Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin Janar 2025”.

Miratohet me 15 vota pro, abstenim ska, kundër ska

SEKRETARE
Refaela Xeba

KRYETAR
Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 498 Prot.
13

Patos më 03 03.2025.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 26.02.2025 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së pestë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin Janar 2025”.

Edhe për këtë pikë, është mbledhur komisioni i Ekonomisë dhe i ka kaluar këshillit me votë unanime.

Elda Goxhaj Drejtore e Mbrojtjes Sociale dhe Politikave të Arsimit, Sektori i Shërbimit Social- Drejtorja e Mbrojtjes Sociale dhe Politikave të Arsimit, Sektori i Shërbimit Social propozon të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondet e kushtëzuara 6% për muajin Janar 2025 gjithsej 19 familje me një fond prej 79,418 (shtatëdhjetë e nëntë mijë e katërqind e tetëmbëdhjetë) lekë.

Familjet përfituese sipas listës dhe relacionit bashkëngjitur.

Armand Ahmetaj- Keni ndonjë pyetje?

Armand Ahmetaj – Nëse s’kemi pyetje të tjera kalojmë në miratim. Nëse s’kemi pyetje të tjera unë propozoj ta kalojmë në votim pikën e pestë Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin Janar 2025”.

Armand Ahmetaj –Kush është dakord për miratimin?

Miratohet me 15 vota pro, abstenim ska, kundër ska

SEKRETARE
Refaela Xeba

KRYETAR
Armand Ahmetaj

Bendolë Shyqete
Edmond Fort
Artem N. Kani



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 5211 / Prot.

Patos më 03 .03.2026.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 26.02.2024 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së gjashtë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për miratimin e bonusit të qirasë për qytetarin z. Qerem Zyberi”.

Armand Ahmetaj- Ftojmë ekzekutivin

Arben Shpërdheja - Në vijimësi të kërkesës të z. Qerem Zyberi për të përfitur bonusin e qirasë si familje në nevojë theksojmë se:

Z. Qerem Zyberi banues në lagjen “Naftëtari” Patos, ka plotësuar dokumentat për tu trajtuar me një nga format e strehimit sipas ligjit nr. 22/2018 “Për strehimin Social”, dhe figuron në listën e strehimit. Familja e tij përbëhet nga 5 persona. Bazuar normave të strehimit kjo familje duhet të strehohet në banesë 2+1. Të ardhurat e familjes janë në total 22,304 (njëzetë e dy mijë e treqind e katër) lekë. Sipas kontratës së qirasë me nr. repertori 431, nr. koleksioni 197, datë 01.03.2022, familja e z. Qerem Zyberi jeton në këtë banesë, me numër pasurie 21/11+3-25, zona kadastrale 2890, volumi 13, faqe 54, me sipërfaqe 49 m² (dyzetë e nëntë) në lagjen “Naftëtari”, me një afat kohor kontrate 1 (një) vjeçarë. Në V.K.B nr. 87 datë 19.12.2024 për miratimin e buxhetit 2025, është miratuar zëri rimbursimi i familjeve të pastreha për bonus qiraje. Për familjet që si pjesë taksuese sipas normave të strehimit duhet të strehohen në banesën 2+1, vlera në tregun e lirë e tetstuar është 6,000 (gjashtë mijë) lekë dhe rimbursim 50% e vlerës është e barazvlefshëme me 3,000 (tre mijë) lekë në muaj. Për periudhën një vjeçare Janar-Dhjetor 2025 një vlerë totale 36,000 (tridhjetë e gjashtë mijë) lekë. Kjo vlerë të rimbursohet me dy këste, pasi qytetari mund ti ndryshoj statusi social. Në zbatim të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, ligjit nr. 22/2018 “Për strehimin social” pika 2, gërma “a” dhe V.K.M-së nr. 459 datë 03.07.2019 “Për rregullat për administrimin e kërkesave të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionin e qirasë ose uzufruktit, mënyra e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehim, si dhe V.K.B-së nr. 87 datë 19.12.2024 për miratimin e buxhetit, i kërkojmë Këshillit të Bashkisë, miratimin e këtij projektvendimi.

Eduart Faslliaj -Këto janë familje që trajtohen me banesë sociale ndaj bashkisë dhe ju kompesohet bonusi? Çfarë statusi kanë këto si familje?

Arben Shpërdheja- Bashkia Patos jep banesa me qira ose subvencionim i qirasë deri në masën 50% të vlerës së tregut që do të thotë lista e strehimit vete 120-130 veta, ne kemi 60 banesa me qëra , 57,59 dhe nuk mund ti plotësojmë të gjitha por i jep mundësinë qytetarëve ta gjejne një banesë në treg dhe në bazë të numrit të strehimit ta rimbursojmë atë vlerë që do paguante vet qytetari

Eduart Faslliaj- Tek pjesa që subvencionohet për familjet si procedohet? Familjet parashtrojnë kërkesë vet pranë bashkisë apo përzgjidhen?

Arben Shpërdheja- Kërkesë pranë bashkisë

Armand Ahmetaj – Nëse s’kemi pyetje të tjera unë propozoj ta kalojmë në votim pikën e gjashtë Projekt-vendim “Për miratimin e bonusit të qirasë për qytetarin z. Qerem Zyberi”.

Miratohet me 15 vota pro, 0 kundër , abstenim ska.

SEKRETARE

Refaela Xeba

KRYETAR

Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 5204 Prot.
13

Patos më 03 03.2025.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 26.02.2025 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së shtatë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për miratimin e bonusit të qirasë për qytetarin z. Bardhul Aliaj”.

Armand Ahmetaj – Projektvendimi ka të njëjtën natyrë.
Meqë është e njejta natyrë kalojmë në votim?

Armand Ahmetaj –Kush është dakord?

Miratohet me 15 vota pro, abstenim ska, kundër ska.

SEKRETARE
Refaela Xeba

KRYETAR
Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 2661 / 5 Prot.

Patos më 03 .03.2025

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 26.02.2025 ora 14:00 , në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së tetë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Raporti për vlerësimin dhe parashikimin afatmesëm të të ardhurave të veta (Bashkia Patos 2026-2028)”.

Ekzekutivi relatton materailin.

Çajup Refitaj – Mirëdita të gjithëve! Në parashikimin afatmesëm të projektbuxhetit për periudhën 2026-2028 jemi mbështetur në bazën ligjore në cilën funksionon autoriteti gjithashtu dhe në paketën fiskale të miratuar për vitin 2025, gjithashtu janë dhe vitet bazë të cilat ne mbështetemi që janë dy vite paraardhëse që është viti 2023 dhe viti 2024 mbështetur mbi këta tregues faktik por natyrisht edhe mbi bazat e tatueshme ku kemi bazë të tatueshme për taksat e ndërtesave trojet, tokat bujqësore, dhe tabelat gjithashtu edhe tarifat për të cilat ne aplikojmë mbi banorët të cilat i kemi shprehur në paketën fiskale. Kemi bërë një parashikim për vitin 2026 dhe vitin 2028. Vijnë më një realizim nga viti 2024 për vlerën 286 milion 671 mijë në 94%. Natyrisht në parashikimin 2026 ,2027 dhe 2028 janë marrë parasysh dhe faktorë tjerë tjerë të cilët ndikojnë por ne kemi bërë një rritje të lehtë duke ndërhyrë në taksat kombëtare sepse ne jemi përfitues të taksave kombëtare siç është renta minerare nga shfrytëzimi hidrokarbureve gjithashtu edhe taksat e mjeteve të përdorura në kushtet që kemi parë realizimin për këto dy zëra por veçanërisht atë të mjeteve të përdorura që ka qenë me tejkalim ne kemi parashikuar një rritje të lehtë për vitet në vazhdim 2026-2028. Praktikisht parashikimi për vitin 2025 është 312 milion 582 mijë. Shifrat janë të shprehura mijra lekë 26 siç e thashë me ndërhyrjet që janë bërë për rritje në taksat kombëtare është parashikuar në 313 milion 582 mijë. Viti 2027 është 314 milion 582 mijë, gjithashtu dhe 2028 ka ngeluar në të njëjtën shifër duke qënë se i largohemi disi parashikimeve dhe vëshirohet sa më larg. Jemi në mbulimin e buxhetit total për këto vite afrohem në masën 50% pasi në 2025 e kemi 46% natyrisht janë parë edhe po themi dhe efektet tjera efektet po themi të inflacionit apo dhe përjashtimet që ne kemi parashikuar për grupet siç janë pensionist invalidë etj gjithë këto janë paraparë gjatë hartimit të planifikimit për këtë buxhet afatmesëm.

Ky ishte në mënyrë të përmbledhur pjesa e parashikimit për këtë periudhë.

Eduart Faslliaj- ju thatë se keni parashikuar një rritje të vlerës të taksës të mbledhur tek mjetet e përdorura për vitet që do të vijnë.

Ku e keni bazuar këtë në rritjen e numrit të mjeteve apo në rritjen e vlerës taksës?

Se mesa po shikojmë numri i popullsisë sa vjen për bie sigurisht dhe numri i mjeteve do të bjerë kështu që nuk e shkoj objektiv këtë.

Çajup Refitaj – Unë në relativitet e shpreha e kemi mbështetur në realizim fakti që realizimi i 2024 na tregon që kjo taksë ka qënë me tejkalim ne kemi parashikuar një trend rritës natyrisht jo në vlerë aq të mëdha po bëhet fjalë për 1 milion lekë rritje. Për pjesën e mbledhjes ne këtu operojmë me agjentë tatimor në këtë rast sepse mbledhësi në këtë rast është drejtorja e rrugëve dhe më pas bëhet kalimi i fondeve pranë bashkive përkatëse aty ku vet mjetet kanë regjistrimin ose vendndodhjen e pronarit

Eduart Faslliaj- Ne na kërkohet ta votojmë këtë projektvendim apo thjesht të marim informacion?

Armand Ahmetaj – Të miratohet. Është projektvendim.

Nëse s'kemi pyetje të tjera unë propozoj ta kalojmë në votim pikën e tetë Projekt-vendim “Raporti për vlerësimin dhe parashikimin afatmesëm të të ardhurave të veta (Bashkia Patos 2026-2028)”.

Armand Ahmetaj –Kush është dakord

Kundër ska, abstenim ska, miratohet me 15 vota pro.

SEKRETARE

Refaela Xeba




KRYETAR

Armand Ahmetaj



Refaela Xeba
Armand Ahmetaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 523 Prot.
16

Patos më 03.03.2024.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 26.02.2025 ora 14:00 , në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së nëntë të rendit të ditës.

Shqyrtimi i kërkesës nr. 4202 prot., datë 20.11.2024 për dhënie ndihmë financiare.

Armand Ahmetaj- Ëngjëll Xhanari personi që ka bërë kërkesën. Ftoj ekzekutivin Andi Kola- Përgjegjës në Drejtorinë e Financës- Fondi për këtë është miratuar nga fondi rezervë në masën 150 mijë lekë të reja për personin Ëngjëll Xhanari. Fondi rezervë në 2025 është parashikuar si program më vete.

Eduart Faslliaj- unë tek dokumentacioni që pash nuk pash kartel mjekësore, nuk jam kompetent për këtë pjesën, pash një kartel që ishte në anglisht unë nuk i vij dot vërdallë por nuk di nëse e kanë kuptuar të tjerët dhe ne kemi dakorduar këtu që do trajtojmë më ndihmë ekonomike sepse rastet e kësaj natyre që urojmë të jenë sa më të pakta por që në faktë janë goxha raste dhe sigurisht ne jemi me dëshirën e mirë që ti ndihmojmë të gjithë me aq sa mundësitë janë por që të jemi objektiv që ta çojmë atë ndihmën që kemi në dorë atje ku duhet dhe për faktin se nuk pash një raport mjekësor në këtë rast nuk jam dhe i sqaruar. Nuk e di komisioni i shëndetësisë nëqoftë se e ka parë rastin dhe në qoftë se e ka studiuar raportin mjekësor. Në dokumentacion nuk ishte. Ishte një raport në anglisht. Zv/ Kryetarja Ina Sauli - Bashkëlidhur ndodhet dhe epikrizja

Albiona Lamaj- dokumentacioni që është dërguar në email deri diku parafolësi ka të drejtë sepse dokumentacionin mjekësor është në anglisht nuk ka dokumentacion në shqip por unë po e marrë fjalën dhe si mjeke në atë çfarë shkruhet atje thuhet që ka shumë diagnoza por ndër të cilat diagnozë është edhe sëmundja terminale kancer dhe në atë që ne kemi të përcaktuar si rregullore përpara në shpërblimet që do të japim për fazat terminale kjo i plotëson kriteret mjekësore unë mendoj që ne duhet ta kalojmë se është sëmundjeve dhe pastaj pjesa e mjekut familjes të plotësohet edhe me epikrizën në shqip për ta patur këshilltarët por që në diagnozë që ka është sëmundja terminale në atë epikrizë që ka në gjuhën angleze

Armand Ahmetaj- Dua të propozoj që ti shtojmë vendimit dhe dokumentacionin e plotë ligjor, pra ta kalojmë por ti shtohet dhe dokumentacioni i plotë ligjor para se të kaloj vlera sepse është dhe kusht ligjor nuk diskutohet. Ajo është ligjore por jo anglisht.

Armand Ahmetaj –Kush është dakord për pikën nëntë ? Shqyrtimi i kërkesës nr. 4202 prot., datë 20.11.2024 për dhënie ndihmë ekonomike Ëngjëll Xhanari .

Kundër ska, abstenim ska, miratohet me 15 vota pro.

SEKRETARE

Refaela Xeba

KRYETAR

Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 515 Prot.
710

Patos më 03.03.2024.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 26.02.2025 ora 14:00 , në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së dhjetë të rendit të ditës.

Informacion mbi raportin e monitorimit të zbatimit të buxhetit për 4- mujorin e tretë dhe prej fillimit të vitit 2024.

Bazuar në nenin 48, pika 1 e ligjit nr. 68 datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, nenin 65, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, nr.22 datë 30.07.2018, “Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit të njëjësive të vetëqeverisjes vendore”, nenin 9 pika 1.3 germa ç, neni 34 pika 6, e ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të udhëzimit plotësues nr.8, datë 13.01.2017 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, është miratuar raportin e monitorimit për 4- mujorin e tretë dhe prej fillimit të vitit 2024.

Plan buxheti i vitit 2024 është 846,988,566 ndërsa realizimi është 579,421,577 lekë. Realizimi është 68% e planit total të buxhetit për vitin 2024. Nga këto investimet janë realizuar 50%. Një pjesë janë në proces zbatimi dhe pjesa tjetër ka kaluar tek fondet e trashëguara në vitin 2025 që janë miratuar.

Eduart Faslliaj- Bazuar mbi monitorimin që ju keni bërë të buxhetit 4 mujorit të fundit dhe buxhetit në përgjithësi të vitit që ka kaluar, ne kishim dy investime kapitale në buxhetin e vitit të kaluar. Kanë qënë dy rrugë në lagjen “Mustafa Matohiti” rruha e burimit të lajthisë që ishte shkruar burimi i xanës gabimisht dhe rruga e Rrapushajve. Gjithashtu ka qënë dhe një rrugë në pjesën qendrore të fshatit Gjynaqarë që ishte parashikuar me dy buxhete. Gjysma e investimit ishte në buxhetin e këtij viti. Mund të na thoni nga monitorimi pse nuk janë realizuar, kush ka qënë arsyeja?

Andi Kola- Agjencia e Shërbimeve Publike ka bërë planin e punës, kontaktat janë lidhur dhe janë në proces zbatimi. Ato kaluan në vitin 2025. Janë planet e punës që ka Agjencia e Shërbimeve Publike.

Artan Velçani- Për ato që ai foli bëhët fjalë për buxhetin e vitit 2025 ku janë parashikuar rrugët të cilat ai i përmëndi, si rruget e burimit të lajthisë apo xanës ndërsa raporti i monitorimit është për 4 mujorin e fundit të vitit 2024.

Eduart Faslliaj- Sa për sqarim bën sikur nuk e di apo vërtet nuk e di kjo është buxheti vitit 2024, kaluan si fonde të trashëguara në vitin 2025 dhe unë këtë po pyes kush ishte shkaku që nuk u realizuan? Mund të sqaroj kryetari se te kush buxhet kanë qënë këto dy investime kapitale?

Armand Ahmetaj- Të sqaroj ekzekutivi ndaj e kemi këtu për ti sqaruar këto gjera.

Andi Kola- Në mënzrë të detajuar i ka Agjencia e Shërbimeve Publike se unë e kam të përmbledhur blerje asfalto beton.

Eduart Faslliaj- Nga dokumentacioni që keni shfletuar për pjesën e kohës që jeni në detyrë këto janë investime të buxhetit të vitit 2024 të trashëguara në buxhetin e vitit 2025

Andi Kola – Ato që thatë ju në vitin 2025 zbatohen tani. Janë në proces zbatimi, prandaj kanë kaluar në këshill për tu vazhduar në 2025.

Eduart Faslliaj- Dua një sqarim serioz nga instancat përkatëse. Unë jam i bindur për këtë por besoj se dhe ju e keni informacionin e duhur që këto dy investime janë të vitit 2024 që nuk u realizuan, u mbarën dhe u trashëguan për buxhetin e 2025, e kemi bërë debat dhe një herë tjetër ku unë dyshova që këto ishin përdorur politikisht ndaj dhe po pyes se kush ka qënë arsyeja që nuk u realizuan sepse paratë ishin. Mua më lind e drejta të dyshoj se do përdoren për fushatë elektorale, dhe do realizohen në fillim të vitit 2025 dhe që nuk është gjë e drejtë. Sigurisht që mua më lind e drejta të bëj dhe padi në instancat përkatëse për shpërdorim detyre ose keqpërdorje buxheti gjithsesi nga ju desha një informacion, jo nga këshilltarët.

Andi Kola- Fondet që trashëgohen në 2025, në bazë të atyre ka tregues performace për ne nga Ministria e Financave, dhe realizimi i investimeve për vitin 2024 është një tregues i performancës dhe sa më shumë të bëhen investime për një vit aq më e lartë është performanca për bashkinë.

Albiona Lamaj- Nuk ekziston në termin ekonomik një fondi trashëguar në momentin që trashëgohet ose kalon buxhetin e 2025 quhet buxhet I 2025 dhe nuk quhet më buxheti i 2024 dhe momentin që ka ndodhur kjo gjë dhe ne kemi hedhur në votim janë treguar dhe arsyet përse ka ndodhur kjo gjë janë shpjeguar arsyet përkatëse kështu që pyetja e këshilltarit mua më duket pa sens për tu bërë sot se shpjegimet janë dhënë momenti që ato kanë kaluar në buxhetin e 2025 dhe e treta nëse shikon që ka ndodhur një diçka e tillë përpara se ta thojë këtu ai që vërtet mendon se se ka ndodhur diçka e tillë e çon në instancat përkatëse jo të marri mikrofonin dhe të bëjë demallogji edhe politikë në këshillin bashkiak

Erald Çepele- Dua të bëj një ndëryrje lidhur me buxhetin e vitit 2024, ka një rregull ekonomik dhe projekt buxheti në tërësi është parashikim, ne bëjmë parashikom si 2023, 2024 si 2025 e me radhë jo do të thotë jo 100% të realizohet as 90% AS 80% por mund të bëhet dhe 50%, gjithmonë këto të ardhurat, shpenzimet dhe investimet ecin paralel me të ardhurat pastaj janë dhe procedurat e tjera të tenderimit, mund të mos paraqitet asnjë operator për të hyrë për blerje baze materiale, mund të ketë procese ankimimi këto ia kalojnë afatet dhe detyrimisht kalojnë në vitin tjetër. Nuk realizohen 100%. Jo për fushatë që nuk do realizohen siç e tha dhe kolegu opozitar mund të mos bëhen dhe për shkak të motit, pse nuk themi ne që meqë jemi vit elektorale njëzë të përfitojnë nga situata dhe mos të paguajnë taksa. Po spate lekët si do ti bësh investimet.

Armand Ahmetaj-Kalojmë në pikën tjetër.


SEKRETARE

Refaela Xeba



KRYETAR

Armand Ahmetaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 522 / Prot.

Patos më 03.03.2024.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 26.02.2025 ora 14:00 , në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së njëmbëdhjetë të rendit të ditës.

Informacion mbi inventarët jashtë përdorimit nga Drejtoria e Financës

Andi Kola- Relaton Informacionin e paraqitur me shkrim-

Në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 "Per menaxhimin financiar dhe kontrollin", udhezimit nr. 30, datë 27.12.2011 pika 106, dhe I ndryshuari datë 17.11.2014, të VKB nr 28, datë 18.05.2018 "Per miratimin e rregullores së menaxhimit të aktiveve të Bashkise Patos" urdherit nr. 266, datë 01.11.2024 "Mbi inventarizimin dhe vleresimin e inventarit të vitit 2024", totali i inventarit të nxjerrë jashtë përdorimit për vitin 2024 është 1,855,906 lekë .

Pjesën më të madhe të inventarit jashtë përdorimit e zë inventar i imët në vlerën 1,404,468 lekë.

Armand Ahmetaj- Kemi ndonjë pyetje? Meqë skemi propozoj të mbyllim mbledhjen.

SEKRETARE
Refaela Xeba

KRYETAR
Armand Ahmetaj

Pendolla Shyreta
Ednat Fortaj
Artan Vetrari